

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 paragrafi (5) të Rregullores gjyqësore dhe nenit 41 të Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 07.12.2021 me Rekomandimin e Byrosë për përfaqësimin e RMV mbi lëndën *Bajiq kundër RMV*, A.nr.2833/13 të datës 10 qershor 2021, për zbatimin konsekuent të parimit të barabarësisë së mjeteve dhe kontradiktës së procedurës penale nxori këtë:

## **K O N K L U Z I O N**

Përgjigjja e Prokurorit Publik të RMV në lëndët mbi kërkesën për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm iu dërgohen parashtresve të kërkesave në formë të shkruar apo në mënyrë elektronike për njohjen e tyre, të cilët mund që sipas nevojës të parashtrojnë koment shtesë në afat prej 8 ditëve nga pranimi, ndërsa sipas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Bajiq kundër RMV*), nr, 2833/13, § 58 dhe § 59, 10 qershor 2021).

Mënyra e këtillë e veprimit në gjykatën do të zbatohet nga data 01.01.2022.

**SEKTORI I VEPRAVE PENALE**